



**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**  
**SENATI AKADEMIK**

Nr. .... Prot.

Vlorë, më 05.04.2017

**Vendim**  
**Nr. 47, datë 05.04.2017**

**PËR RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT EKZISTUES TË STUDIMIT**  
**"MASTER I SHKENCAVE NË SHKENCA INFERMIERORE"**  
**NË FAKULTETIN E SHËNDETIT PUBLIK**

Në mbështetje të pikës **9** në nenin **35**, nenit **70**, nenit **75**, nenit **38** në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit Nr. 15 datë 04. 04. 2008, "Për organizimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 05.04.2017

**VENDOSI:**

1. Të miratojë propozimin e Fakultetit të Shëndetit Publik për riorganizim të programit të ciklit të dytë të studimeve "Master i shkencave në shkenca infermiere" deri në masën 20 si vijon:
  - a. Të shtohet si lëndë me zgjedhje njëra nga modulet e mëposhtme:

Infermieri patologjike e avancuar	
Infermieri kirurgjikale e avancuar	8 kredite
Infermieri pediatrike e avancuar	
  - b. Studenti do të zhvillojë temën e diplomës dhe praktikën profesionale në repartin e zgjedhur nga lënda e mësipërme. Një pjesë e krediteve të temës së diplomës do të merren nga praktika profesionale, gjatë së cilës do të zhvillohet studimi shkencor për mbrojtjen e diplomës.

Tema e Diplomës: 20 kredite
Praktika profesionale: 10 kredite
  - c. Gjithë modulet e tjera të programit janë module ekzistuese.



**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**  
**SENATI AKADEMIK**

---

- d. Në funksion të kompesimit të krediteve të lëndës së shtuar janë hequr nga programi modulet: Sistemet e Informacionit në shëndetësi dhe E drejta në Infermieri.
2. Të saktësohet emërtimi i kodit të lëndës "Gjuhë e huaj për infermierinë" nga INF në ENG/ITA/FRE/GER/SPA.
  3. Programi i miratuar është bashkëlidhur këtij vendimi.
  4. Vendimi regjistrohet dhe arkivohet.
  5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**  
**Prof. Dr. Roland ZISI**

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.